



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-21-0003

Në ankesën e

Paditësja/Ankuesja

D T Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit **B I**, av Prishtinë.

kundër

E paditura

NSH "D" Prishtinë(në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr." Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1145 të datës 16 dhjetor 2020, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 shtator 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1145 i datës 10 gusht 2020, dhe vendimi i Autoriteti të Likuidimit , PRN 105/0025 i datës 10 qershor 2013 .**
- 3. Obligohet e paditura ti paguaj paditësit ne emër te pagave te pa paguara për periudhën 1 mars 2006 e deri 30 nëntor 2006 ne**

shumen prej 540,00 euro , interesin ligjor prej 10% , në shumën prej 54 euro , si dhe shpenzimet e përfaqësimit te avokatit në shume prej 208,00 euro , sipas prioriteteve te përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 04 korrik 2013, paditësi, ka parashtruar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN105-0025, të datës 10 qershor 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 540.00 euro, nga NSH "D", në Prishtinë (në likuidim). Autoriteti i likuidimit kërkesën e kishte refuzuar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar duke vlerësuar se ajo është parashkruar. Në ankesë paditësi ka pohuar se konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar është i gabuar pasi që ajo nga ish AKM-ja ka pranuar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 17.11.2006, dhe në njoftim ajo ishte udhëzuar që pas fillimit të procedurës së likuidimit ajo do të informohet për mundësin e paraqitjes së kërkesës për paga të pa paguara. Ai pohon se kërkesën e ka paraqit tek Autoriteti i Likuidimit me datë 01 dhjetor 2010, por është refuzuar si e pa bazuar me arsyetimin e gabuar se kërkesa është parashkruar. Paditësi bashkë me ankesë ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe Njoftimin e AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 17 nëntor 2006.

Me datë 08 prill 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja i kundërshtoi pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për paga të pretenduara ndaj NSH-së, andaj kërkesa është parashkruar. Tutje AKP-ja pohon se me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 17.11.2006, AKM-ja nuk ka pranuar as një obligim financiar ti paguaj paditësit , dhe paditësi nuk mund

të mbështesë kërkesën e tij në këtë provë. Detyrimi i NSH-së i pohuar nga paditësi, nuk është mbështetur me asnjë provë. Letra informuese thjeshtë e informonte paditësin që kishte mundësi të paraqesë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit lidhur me një pretendim që ishte ligjërisht e detyrueshme për NSH-në. AKP-ja pohon se ky njoftim nuk paraqet pranim të borxhit për paga lidhur me kërkesën për paga që ishte parashkruar. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 03 shtator 2015, paditësi e dorëzon edhe një parashtresë në DHPGJS dhe e plotëson padinë. Në këtë parashtresë paditësi për veç borxhit kryesor, kërkon kamatën ligjore, në baze të nenit 277 paragrafi 1 i LMD-së në shumë prej 228,58 euro, kamatë vonesën si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 104 euro.

Me datë 16 dhjetor 2020, shkalla e pare e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1145 e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejt dhe të bazuar në ligj. Shkalla e pare e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 01 dhjetor 2010, ankuesi ka dështuar të paraqes ndonjë provë me të cilën do të dëshmonte pretendimet e tij në ankesë si dhe ka dështuar të dëshmoj se ndonjëherë më parë pagat janë kërkuar para ndonjë gjykate kompetente, andaj kërkesa është parashkruar në muajin mars 2009. Tutje Shkalla e pare ka arsyetuar se e paditura me të drejtë është thirr në parashkrimin e kërkesës duke u bazuar në dispozitat e nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Shkalla e pare e DHPGJS-së konstaton se edhe sipas nenit 137 të LMD-së të vitit 1978, afati i parashkrimit në kërkesat monetare është tri vite. Prandaj në bazë të këtyre dispozitave ligjore, kërkesa e paditësit për paga është parashkruar.

Me datë 30 dhjetor 2020, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të shkallës së shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-13-1145 të datës 16 dhjetor 2020, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të

anulohet vendimi i autoritetit të likuidimit, të aprovohet padia si e bazuar, dhe të detyrohet NSH "D", e përfaqësuar nga Autoritetit i likuidimit ta paguaj shumën prej 540.00 euro në emër të pagave të papaguara me kamat vonesën prej 3.5%, prej 01.04.2006, në shumë prej 113,40 euro dhe kamatën prej 8% prej datës 19.12.2012 në shumë prej 459.00 euro deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 520,00 euro. Për më tepër në ankesë ankuesi pohon se më datë 17 nëntor 2006, ish AKM-ja i ka dërguar një letër informuese ankuesit me të cilën ai është informuar se si pasoj e shitjes së asetëve me datë 17 nëntor 2006 është përfundimi i punësimit tuaj dhe kjo letër është njoftim zyrtar për ju se punësimi i juaj përfundon menjëherë, ndërsa pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit më punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura. Tutje ankuesi konsideron se letra informuese për ndërprerjen e marrëdhënies së punës konsiderohet si pranim i detyrimit dhe i përmbushjes të të gjitha detyrimeve që mund të vërtetohen nga ankuesi. Gjykata e shkallës së parë është bazuar në konstatimet e Autoritetit të likuidimit dhe nuk ka shqyrtuar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa e zbaton një bazë ligjore tjetër të refuzimit të kërkesës, duke aplikuar LMD-në që nuk e ka zbatuar Autoriteti i Likuidimit. Tutje paditësi ka pohuar se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar Aktgjykimin e vet duke përdorë argumente juridike në dobi të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të cilat argumente nuk ishin përmendur fare në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Paditësi pohon se objekt i shqyrtimit duhej të ishte përmbajtja e vendimit të Autoritetit të Likuidimit ashtu si ishte në kohën e nxjerrje së tij, ndërsa gjykata ka gjetë një bazë të re të refuzimit të ankesës. Ankuesi në ankesë i referohet disa rasteve të jurisprudencës së DHPGJS-së dhe në bazë të rasteve të tilla ai pretendon se letra informuese flet për paga dhe kërkesat tjera kreditore të cilat paditësja i ka ndaj NSH-së në likuidim. Ankuesi kërkon nga Kolegji i Apelit që të miratohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet vendimi i Autoritetit të likuidimit PRN105-0025 i datës 10 qershor 2013, të miratohet kërkesë padia si e bazuar dhe të detyrohet e

paditura të paguaj shumën e kërkuar në emër të pagave të papaguara si dhe interesin ligjor, dhe ti paguaj shpenzimet e kërkuara procedurale.

Më datë 10.02.2021, AKP-ja e dorëzon një parashtrësë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankueses. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore se ankueses duke i konsideruara si të pabazuara në ligj dhe e mbështet në tersi Aktgjykimin e ankimuar te shkallës së parë DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm. AKP-ja pohon se argumentet e saja i ka sqaruar mjaftueshëm në mbrojtje në ankesë , andaj ato nuk do të përsëriten nga se kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe të aprovet padia si e bazuar

Paditësi me padinë e tij të dorëzuar në DHPGJS me datë 04 korrik 2013, ka kërkuar që të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të likuidimit PRN105-0025 i datës 10.06.2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për pagesën e pagave të papaguara në shumë prej 540,00 euro, duke vlerësuar se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608, të Ligjit të Punës së Bashkuar. Autoriteti i likuidimit ka konstatuar se kërkesa për paga është dorëzuar me 01 dhjetor 2010.

Shkalla e pare e DHPGJS me aktgjykimin e ankimuar e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke e vlerësuar se kërkesa për paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me konstatimet e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkalles së parë të DHPGJS se kërkesa është parashkruar, pasi që është e qartë se AKM-ja paditësit i ka dërguar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me date 17 nëntor 2006, i cili dokument e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit të kërkesës.

Ne këtë njoftim shprehimisht ceket se "Shumat – pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktohen i kur të fillojnë këto procedura".

Duke u bazuar në këtë Njoftim, paditësi me arsye ka pritur fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-se me datë 08 nëntor 2010, dhe pastaj pas njoftimit të shpallur nga AKP-ja, paditësi në afatin ligjor e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit me date 01 dhjetor 2010.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar në DHPGJS me date 08 prill 2014, e kundërshton kërkesën për paga vetëm për shkak të parashkrimit, ndërsa nuk ka ndonjë kundërshtim shprehi mor lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit në shume të kërkuar prej 540,00 euro.

Andaj duke u bazuar në faktin që lartësia e kompensimit nuk është kundërshtuar, këtë fakt të pakontestuar e konsideron Gjykata si të provuar, prandaj paditësit i është njohur e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara për muajt mars e deri nëntor 2006 në shume prej 540.00 euro, ndërsa në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet e drejta edhe në interes ligjor në lartësi prej 10% të borxhit kryesor, ose në shumën prej 54,00 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në bazë të nenit 62 të LDHP-së, në

shume prej 208,00 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve te përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është aprovuar si e bazuar, është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkalles së pare dhe vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, si dhe është aprovuar padia e paditësit si a e bazuar.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 01 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 shtator 2021.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
